2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Në zbatim të Njoftimit të Përbashkët Nr.8480 Prot., datë 30.12.2020 nga APP dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Operatori ekonomik duhet të ketë:

Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatim paguesit që përdorin Platformën Qëndrore të Faturave.

Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Çertifikuar për zgjidhjen software-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike. Per plotesimin e këtij kriteri te paraqiten te paraqitet dokumentacioni i kerkuar mesiper.

Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Vërtetim për xhiron mesatare vjetore për vitet 2017, 2018 dhe 2019 në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.
- Kopje të vërtetuara të bilanceve të viteve ushtrimore 2017, 2018 dhe 2019 të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse.
- Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019, 2020 nga njësitë e qeverisjes vendore ku ka pasur selinë e zhvillimit të aktivitetit dhe ne te gjitha niptet sekondare qe operatori ka ne QKB.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përvojë e suksesshme në :

2.3.1 Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, ose

Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i fondit limit të kontratës që prokurohet.

- a. Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike ofertuesi duhet të paraqesë:
 1. Formularin e vleresimit, shoqëruar me:
 2. Kontratë
 3. Situacionin përfundimtar;
 4. Aktin e kolaudimit;
 5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim.
 6. Faturat tatimore

- b. Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat ofertuesi duhet të paraqesë:
 - Kontratë / vërtetime ku shënohet, vlera, koha dhe natyra e punës së bërë
 - Faturat tatimore përkatëse për çdo situacion.
 - Formular vlerësimi , shoqëruar me aktin e kolaudimit dhe situacionin perfundimtar.

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, ofertuesi duhet të paraqesë krahas dokumentacionit të mësipërm: dhe kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë :

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) **Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportime mbetjeve Urbane”.**

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për **“Sherbime ekspertize dhe /ose profesionale të mbrojtjes civile” (Kodi I.2.A).**

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për **“Sherbime nderhyrese higjeno- shndetësore” (Kodi II.8.B).**

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë ne Licencën e shoqërisë Drejtuesit Teknik të mëposhtem: dy inxhinier ndertimi profili Transport, dy inxhinier mjedis, dy inxhinier gjeolog, një inxhinier minierash, dy inxhinier mekanik, dy inxhinier hidroteknik, dy inxhinier gjeodet, dy inxhinier elektrik, dy inxhinier ndertimi (strukturist), një arkitekt me licence në projektim.

Per plotesimin e ketoj kriteri duhet te paraqiten: Diplomat respektive per secilin Drejtues Teknik, Librezen e Punes, Kontraten e Punes, dhe te figurojne ne listepagesat e subjektit per periudhen e 3 muajve te fundit nga hapja e ofertave.

2.3.6 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem:

- a) Librezë pune (përkatëse)
- b) CV përkatëse
- c) Kontratë pune e vlefshme
- d) Diplomë

2.3.7 Shoqëria duhet të ketë në personelin e saj 1 (një) Ekspert Mjedisor, për hartimin e raporteve të vlerësimit dhe ndikimit në mjedis dhe për të kryer auditimin mjedisor, hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi, shoqëruar me dokumentacionin përkatës ligjor-profesional, si Diplome, Certifikatën Mjedisore lëshuar nga Ministria Mjedisit, kontratën të punës, i cili të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga hapja e ofertave .(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) Ekspert Mjedisor.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1 (një) mjek të përgjithshëm** të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga hapja e ofertave. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, librezë

pune, diplomën përkatëse. *(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) mjek të përgjithshëm).*

- 2.3.9** Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë **tre inxhinier** që përmbushin kriteret për të qenë **Pergjegjes/koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve**, të cilët duhet të jenë të pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (Pergjegjes/kordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, certifikaten e ekspertit, CV, librezë pune, diplomën përkatëse dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë 3 (tre) muajt e fundit nga hapja e ofertave. *(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) pergjegjes per sigurine).*
- 2.3.10** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **2 (dy) inxhinier “Ekspert per Auditim energjie”** të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë 3 (tre) muajt e fundit nga hapja e ofertave. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, certifikaten e ekspertit, CV, librezë pune, diplomën përkatëse.
- 2.3.11** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **2 (dy) inxhinier “Ekspert Zjarrfikës”** të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë 3 (tre) muajt e fundit nga hapja e ofertave. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, certifikaten e ekspertit, CV, librezë pune, diplomën përkatëse.
- 2.3.12** Operatori ekonomik duhet te ketë në stafin e tij, nje person te certifikuar per **Ndihmen e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave**, i cili duhet te figuroje ne listepagese e shoqërisë 3 (tre) muajt e fundit nga hapja e ofertave.
- 2.3.13** Operatori ekonomik duhet te ketë ne stafin e tij, 1 (nje) **inxhinier** te certifikuar **Pergjegjes per sigurine dhe higjenen ne kantieret e perkohshme te ndertimit**, i cili duhet te figuroje ne listepagese e shoqërisë 3 (tre) muajt e fundit nga hapja e ofertave.
- 2.3.14** Operatori ekonomik duhet te ketë ne stafin e tij, 1 (nje) **inxhinier** te certifikuar (inxhinier mjedisi ose staf me kualifikim te ngjashëm) si **"Përgjegjës për dëmet në mjedis"** gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i cili duhet te figuroje ne listepagese e shoqërisë 3 (tre) muajt e fundit nga hapja e ofertave.
- 2.3.15** Operatori ekonomik duhet te ketë ne stafin e tij, 1 (nje) **inxhinier** te certifikuar **Pergjegjes per vleresimin e risqeve ne kantier**, i cili duhet te figuroje ne listepagese e shoqërisë 3 (tre) muajt e fundit nga hapja e ofertave.
- 2.3.16** Operatori ekonomik duhet te ketë ne stafin e tij, 1 (nje) **inxhinier** te certifikuar **Pergjegjes per sigurimin dhe kontrollin e sigurise sipas ISO 9001:2015**, i cili duhet te figuroje ne listepagese e shoqërisë 3 (tre) muajt e fundit nga hapja e ofertave.
- 2.4** Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare te muajit te fundit, të lëshuara nga institucione të autorizuar shtetërore ose private, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (raporte testimi, prova laboratorike, etj) si dhe ne aktivitetin tregtar te jete perfshire prodhimin dhe perpunimin/tregtimin e materialeve te ndertimit.

2.5 Liçensa profesionale e shoqërise, e vlefshme, me kategoritë:

- NP-1/C “Punime gërmimi në tokë”
- NP-2/C “Ndërtime civile dhe industriale”
- NP-4/C “Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale”
- NP-5/D “Punime nentokesore, ura dhe vepra arti”
- NP-7/E “Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.
- NP -9/C “Punime dhe mbrojtje lumoresistemime hidraulike dhe bonifikimi
- NP-12/A “Punime të inxhinierisë së mjedisit”
- NS -8 E "Ndertime parafabrikate beton arme, struktura metalike dhe druri"
- N.S – 9/A "Punime strukturore speciale"
- NS-18/B “Punime topogjeodezike”
- NS-20/A "Shpime gjeologjiko-inxhinierike, puse e shpime per uje"

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturas, Republika e Shqipërisë, sic përcaktohet në *Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM Nr.42, datë 16.01.2008. Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.*

2.6 Operatoret ekonomike të kenë në dispozicion:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 6</i>
2	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 6</i>
3	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 -10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 4</i>
4	<i>Kamioncine me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 4</i>
5	<i>Fadroma me goma per transport dheu</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
6	<i>Autovinc</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 3</i>
7	<i>Autopompe betoni</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
8	<i>Trencher me vakum per shpime nentoksore (per kalim tubosh nen trasene e lumenjve)</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
9	<i>Trencher per hapje kanali (min 20 ton)</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
10	<i>Aparatura per bashkim tubacionesh me metodën “Elektro FUSION JOINT” PE nga DN 25- DN 315</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
11	<i>Aparature elektronike per kontrollin e presionit , Pompe presioni deri 40 bar per te realizuar proceduren e testeve të presionit sipas EN 805</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
12	<i>Motogjenerator / Gjenerator</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 3</i>
13	<i>Eskavator me zinxhir</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 6</i>
14	<i>Eskavator me goma (kove para-mprapa)</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 3</i>
15	<i>Sharre asfalti</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 2</i>
16	<i>Saldatrice / motosaldatrice te kalibruara</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 4</i>
17	<i>Moto pompe thithese vetembushese</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 2</i>
18	<i>Minieskavator</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 2</i>
19	<i>Minifadrome</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
20	<i>Deflektometer ose pjaster dinamike per matjen e ngjeshjes se shtresave rrugore</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
21	<i>Pajisje per hekurkthyes (tranxhe/elektrobango</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Cope 1</i>
22	<i>Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)</i>	<i>në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi</i>	<i>Cope 2</i>
23	<i>Fabrike Asfalto-betoni e pajisur me leje mjedisore, dhe Licensen e QKL, ose kontrate noteriale furnizimi per objektin ne fjale nga nje Subjekt qe disponon fabrike prodhimi materiale betoni shoqeruar me te gjithë dokumentacionin perkates ligjoro-profesional (Leje Mjedisore, Leje Shfrytezimi, Licencen nga QKL</i>	<i>në pronësi / ose kontrate furnizimi</i>	<i>Cope 1</i>
24	<i>Çekic pneumatik per thyerjen e betoneve</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
25	<i>Kompresor ajri</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>

26	Fabrike per prodhimin e materialeve inerte, te pajisur me dokumentacionin ligjor perkates, dhe Licensen e QKL /kategoria B, ose kontrate noteriale furnizimi per objektin ne fjale nga nje Subjekt qe disponon fabrike prodhimi materiale inerte shoqeruar me te gjithë dokumentacionin perkates ligjoro-profesional (Leje Mjedisore, Leje Shfrytezimi, Licencen nga QKL	<i>Në pronësi / ose kontrate furnizimi</i>	<i>Cope 1</i>
27	Depozite uji 5000 lt	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 2</i>
28	Mjet per pastrim bimesh	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>
29	Autorimorkiator per transportin e mjeteve	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 2</i>
30	Fabrike per prodhimin e tuba betoni dhe kesine e pajisur me leje mjedisore, dhe Licensen e QKL, ose kontrate noteriale furnizimi per objektin ne fjale nga nje Subjekt qe disponon fabrike prodhimi materiale betoni shoqeruar me te gjithë dokumentacionin perkates ligjoro-profesional (Leje Mjedisore, Leje Shfrytezimi, Licencen nga QKL	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>
31.	Makineri per prodhimin e kesoneve 300x200cm	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>
32.	Makineri per prodhim tuba betoni	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>
33.	Makineri per prodhim puseta betoni	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>
34.	Makineri per pastrim argjile dhe materiale ne kanalim hapës	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>
35	<i>Instrument gps-total station</i>	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>
36	<i>Matrapik</i>	Në pronësi ose me qera	<i>Copë 3</i>
37	<i>Pompe uji per pastrim</i>	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 2</i>
38	<i>Termometer per matje togezimi</i>	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>
39	Betoniere 0.5m3	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 4</i>
40	<i>Vibrator betoni</i>	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 4</i>
41	Aparat rreze X 250 Kv	Në pronësi ose me qira	<i>Copë 1</i>
42	Aparat rreze X 350Kv	Në pronësi ose me qira	<i>Copë 1</i>
43	Aparat Ultratinguj Konvencional	Në pronësi ose me qira	<i>Copë 1</i>
44	Aparat Ultratinguj Digital	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>
45	Aparat me Pjeseza Metalike ne fushe te magnetizuar	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>
46	Aparat Ultratinguj mates spesori	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>
47	Aparat me Ultratinguj per matjen e spesorit te betonit	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>
48	Aparat me Ultratinguj per kontrollin e uniformitetit te betonit	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>
49	Sonde per hapje pilotash 800 mm	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
50	Grejder	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
51	Asfaltoshtruese	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 2</i>
52.	Autobitumatrice	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
53	<i>Rrul i vogel asfalti deri 4 ton</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 2</i>
54	<i>Rrul asfalti me vibrim gome-gome mbi 13 ton</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
55	<i>Rrul ngjeshes me kompresor gome-hekur mbi 20 ton</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 2</i>

56	<i>Rrul hekur-hekur me kompresor deri 10 t</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 2</i>
57	<i>Tokmak elektrik</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 2</i>
58	<i>Matrapik</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 2</i>
59	<i>Skeleri</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>1000 m2</i>
60	<i>Armature (kallep) derrase</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>	<i>500 m2</i>

Makineritë dhe Pajisjet duhet të jenë në pronësi ose me qira.

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); f) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme), g) license e shoqerise per transport.*
- b) *Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); f) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, ku te percaktohet objekti i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore te blerjes. Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i prokurimi ne fjalet si dhe afati i saj.*
- c) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- d) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- e) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi). (ne rast se ofertuesi eshte bashkim operatoreve, çdo anetar i ketij bashkimi duhet te paraqese kete dokument).*

2.7 Ofertuesi duhet të paraqesë kontratë furnizimi me objektin ne fjale me furnizuesin e tubave që do të vendosen në objekt, shoqeruar me certifikatë e prodhuesit të tubave te betonit konform standarteve *SSHEN 1916:2002 + AC :2008.*

Ne rast se ofertuesi ekonomik nuk eshte i certifikuar te paraqes kontrate sherbimi me subjekt juridik te licensuar dhe akredituar shoqeruar me certifikatat e mesiperme. Ne kontraten e sherbimit duhet te shenohen te dhenat e subjektit qe do kryej sherbimin, objekti ne fjale i prokurimit si dhe adresa dhe numri i kontaktit.

2.8 Ofertuesi duhet të paraqesë kontratë furnizimi me objektin ne fjale me furnizuesin e kesoneve (box-eve) që do të vendosen në objekt , shoqeruar me certifikatë e prodhuesit të kesoneve te betonit konform standartit *SSH EN 14844:2006 + A2 :2011.* Ne rast se ofertuesi ekonomik nuk eshte i certifikuar te paraqes kontrate sherbimi me subjekt juridik te licensuar dhe akredituar shoqeruar me certifikatat e mesiperme. Ne kontraten e sherbimit duhet te shenohen te dhenat e subjektit qe do kryej sherbimin, objekti ne fjale i prokurimit si dhe adresa dhe numri i kontaktit.

2.9 Ofertuesi duhet te paraqese metodologjine e montimit dhe procedurat e saldimit te aprovuara nga inxhinier saldimit me certifikate europiane dhe te mbeshtetura ne laboratore te akredituar ne dakordesi me standartin *ISO 15609-1, 2* dhe standartet mbeshtetese.

Ne rast se ofertuesi ekonomik nuk eshte i certifikuar te paraqes kontrate sherbimi me subjekt juridik te licensuar dhe akredituar shoqeruar me certifikatat e mesiperme. Ne kontraten e sherbimit duhet te shenohen te dhenat e subjektit qe do kryej sherbimin, objekti ne fjale i prokurimit si dhe adresa dhe numri i kontaktit.

2.10 *Ofertuesi* duhet të paraqesë metodologjinë e certifikimit të integritetit të strukturës së salduar nëpërmjet paraqitjes së procedurave e përgjithshme të kontrollit të tegelave të saldimit. Këto të fundit të të përgatitura mbi bazën e specifikimeve teknike dhe kërkesave specifike të projektit, në lidhje me Kodin **EN 1090 "Kërkesat për vlerësimin e konformitetit për përbërësit strukturorë (Shenja CE)" -1 dhe 2 dhe EN 3834 "Kërkesat e Cilësisë për Saldimin" në dakordësi me ISO17636: 2013.**

Ne rast se ofertuesi ekonomik nuk është i certifikuar të paraqes kontratë shërbimi me subjekt juridik të licensuar dhe akredituar shoqëruar me certifikatat e mesipërme. Në kontratën e shërbimit duhet të shënohen të dhënat e subjektit që do kryej shërbimin, objekti në fjalë i prokurimit si dhe adresa e numri i kontaktit.

2.11 *Ofertuesi* duhet të paraqesë Certifikimin e personelit të saldimit sipas **EN 9609:2013 "Testimi i kualifikimit të saldatorëve" dhe IIW "Udhëzimi - Personeli ndërkombëtar i inspektimit të saldimit" dhe Certifikimi i personelit për kontrollin sipas EN 9712: "Personeli i kualifikuar i NDT"**

Ne rast se ofertuesi ekonomik nuk është i certifikuar të paraqes kontratë shërbimi me subjekt juridik të licensuar dhe akredituar shoqëruar me certifikatat e mesipërme. Në kontratën e shërbimit duhet të shënohen të dhënat e subjektit që do kryej shërbimin, objekti në fjalë i prokurimit si dhe adresa dhe numri i kontaktit.

2.12 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si më poshtë:

- 1 (nje) inxhinier gjeomatik (te paraqitet diploma)
- 1 (nje) inxhinier mekanik (te paraqitet diploma)
- 3 (tre) elektrikist
- 2 (dy) saldator te thjeshte
- 2 (dy) teknik (ndërtim, topograf, gjeomatik) (te paraqitet deshmi e kualifikimit)
- 10 (dhjete) manovrator (te paraqitet deshmi e aftesise profesionale)
- 5 (tre) pllakashtrues
- 4 (kater) karpentier te specializuar sipas rregullores P.G.-07.1.1 ne konformitet te standarteve SSH ISO 17024: 2012
- 4 (kater) bojaxhi
- 4 (kater) murator
- 4 (kater) hidraulik
- 2 (dy) hidraulik te specializuar per tensionin e tubave ne presion, sipas rregullores P.G.-07.1.1 ne konformitet te standarteve SSH ISO 17024: 2012
- 2 (dy) mekanik
- 10 (dhjete) Specialist Ndertimi
- 3 (tre) hekurkthyes
- 5 (pese) punonjes ne lartesi (te paraqitet certifikata e kualifikimit)
- 10 (dhjete) Specialist per montimin e tuba HDPE
- 3 (tre) Saldator te pajisur me ISO 9606-1 per saldimit tubash me bashkues te ndryshem (te paraqitet deshmi e kualifikimit sipas standarit ISO 9606-1)

- Për të gjithë punonjësit e mësipërm, përveç dokumentave të kerkuara përbri emërtimit të tyre, duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga hapja e ofertave.

2.13 Një punësim mesatar i të paktën **100 (njqind)** personave, për periudhën e 3 muajve te fundit nga hapaja e ofertave. Per plotesimin e ketij kriteri duhet te paraqiten dokumentat si me poshte:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen e 3 muajve te fundit nga hapaja e ofertave.
- List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e tre muajve te fundit nga hapaje ofertave.

2.14 *Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe te perfshijne objektin e prokurimit:*

- Shoqeria duhet të paraqesë Çertifikatë të cilesisë së punimeve **ISO 9001- 2015 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij**. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.
- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 14001-2015 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij**. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.
- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë **OHSAS 18001-2007 ose 45001-2018 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij**. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.
- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 39001-2012 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij**. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.
- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë **PASS 99:2012 (e vlefshme) (e vlefshme) ose ekuivalente të tij**. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.
- Operatori ekonomik duhet të paraqes certefikate **ISO 50001:2011** per menaxhimin e energjise (e vlefshme) **(e vlefshme) ose ekuivalente të tij**. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.
- Operatori ekonomik duhet të paraqes certefikate **ISO 3834-2:2006** per shkrirjen e metaleve (saldimeve) **(e vlefshme) ose ekuivalente të tij**. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.
- Operatori ekonomik duhet të paraqes certefikate **ISO 27001:2013** per menaxhimin e sigurise se informacionit **(e vlefshme) ose ekuivalente të tij**. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose

organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.

- Operatori ekonomik duhet të paraqes certifikate **ISO 8000 : 2014 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij**. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.
- Operatori ekonomik duhet të paraqese certifikate **DS CEN/TR 15128:2005 (e vlefshme)** ”Per Shqyrtimimi e standarteve europiane per riparimin e sistemeve te kanalizimit dhe kullimit. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO ne raport me % e punimeve qe do kryej).
- Operatori ekonomik duhet të paraqese certifikate **ISO 55001 : 2014 (e vlefshme)** ”Per sistemin e Aseteve. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO ne raport me % e punimeve qe do kryej).

-Certifikatat të jenë në gjuhen shqipe ose te përkthyer dhe të noterizuara.

- *Certifikatat ISO duhet të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
- *Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet te paraqese keto certifikata, ISO sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër ne aktmarrëveshjen e bashkepunimit ne raport me punimet qe do marrin persiper.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t’u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj: Bashkelidhur dokumentave te tenderit.

Specifikimet Teknike të Materialeve: Bashkelidhur dokumentave te tenderit.

Grafiku i Punimeve: 24 muaj nga nenshkrimi i kontrates.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Bashkelidhur dokumentave te tenderit.

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

- Bashkelidhur dokumentave te tenderit.

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 16

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Dokumenta Standarde të Tenderit

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Dokumenta Standarde të Tenderit

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjyqimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës.

Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
